



Raport i mbledhjes së të dhënave sasiore dhe cilësore në fazën e Vlerësimit Afatmesëm



RAPORT MBI TË DHËNAT SASIORE DHE CILËSORE NË KUADËR TË PROGRAMIT RAJONAL NDAL DHUNËS NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE - ZBATOJMË STANDARDET, NDRYSHOJMË MENDËSITË”

Përgatitur nga:
Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve

Dhjetor, 2019

Ky raport është përgatitur nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori) në kuadër të programit Ndaj Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave (NDHNGV), “Zbatojmë Normat, Ndryshojmë Mendësitë”. Ky është një program rajonal, i zbatuar nga UN Women dhe i mbështetur nga Komisioni Evropian. Ai synon të mbështesë zvogëlimin e diskriminimit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave në gjashtë shtete të Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni e Veriut, Mal të Zi, Kosovë¹ dhe Serbi) dhe në Turqi.

Observatori u përzgjedh nga UN Women Shqipëri për ***mbledhjen e të dhënave sasore dhe cilësore***, konkretisht për “*Mbledhjen e të dhënave mbi qëndrimet, perceptimet, opinionet dhe besimet publike aktuale dhe mbizotëruese ndaj barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje në nivel komuniteti*”. Ky bashkëpunim ka filluar që prej muajit Nëntor 2017, duke u ndarë në dy faza të ndryshme:

- Faza e parë: Vlerësimi fillestar (Baseline: nëntor 2017 - prill 2018)
- Faza e dytë: Vlerësimi afatmesëm (Mid-Term Review: shtator - dhjetor 2019).

Në këtë raport paraqiten gjetje sasore dhe cilësore të mbledhura përgjatë fazës së Vlerësimit Afatmesëm.

Metodologjia e ndjekur, e cila është një ndërthurje e qasjeve sasore dhe cilësore, dhe mjetet për mbledhjen e të dhënave janë siguruar nga UN Women, dhe janë unifikuar për të gjitha vendet zbatuese të Programit Rajonal NDHNGV. Mbledhja e të dhënave sasore dhe cilësore u bë nëpërmjet mjeteve të kombinuara vijuese:

(i) Anketa – për mbledhjen e të dhënave sasore (për të siguruar të dhënat për perceptimet dhe qëndrimet e burrave dhe grave lidhur me barazinë gjinore, diskriminimin gjinor, si dhe dhunën ndaj grave dhe vajzave dhe çështjet e dhunës në familje).

(ii) Intervista të thelluara – për mbledhjen e të dhënave cilësore (për nismat e ndërmarra gjatë viteve të fundit në adresimin e stereotipeve gjinore dhe normave tradicionale, të cilat justifikojnë dhunën ndaj grave dhe vajzave dhe dhunën në familje).

(iii) Mbledhje e historive të suksesshme – për të dhëna cilësore (një hulumtim cilësor për të hetuar përvojat më të mira në adresimin e çështjeve të ndërgjegjësimit për DHNGV).

Llogaritja e madhësisë së mostrës dhe diversifikimi i saj u bë në bazë të një niveli fikse besimi prej 95%. Diversifikimi i madhësisë së mostrës u bazua në *gjini, moshë, vendndodhje*, si dhe në bazë të *përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar, dhe persona LGBTI*. Madhësia e mostrës për Shqipërinë është 1260 persona.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Observatorit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women apo të Komisionit Evropian.

¹ Çdo referencë ndaj Kosovës në këtë dokument, qoftë për territorin, institucione apo popullsinë do të kuptohet në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe pa paragjykim për statusin e Kosovës.

Tabela e përmbajtjes

I.	TË DHËNAT SASIORE TË VLERËSIMIT AFATMESËM	4
1.1	Profili i zonave të projektit mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF	4
1.2	Profili i Bashkisë Durrës mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF	5
1.3	Profili i Qarkut Elbasan mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF	6
1.4	Profili i Bashkisë Kamëz mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF	7
1.5	Profili i Bashkisë Korçë mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF	8
1.6	Profili i Bashkisë Shkodër mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF	9
1.7	Profili i Bashkisë Tiranë mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF	10
1.8	Profili i Bashkisë Vlorë mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF	11
II.	TË DHËNAT CILËSORE TË VLERËSIMIT AFATMESËM.....	12
2.1	Grupet e synuara përgjatë 3 viteve të fundit nga programet e implementuara	12
2.2	Kanalet më të përdorur të informacionit	12
2.3	Monitorimi dhe vlerësimi i programeve	13
2.4	Praktikat e suksesshme të identifikuar nga zbatimi i programeve/ fushatave për BGJ, DHnGV dhe DHF gjatë 3 viteve të fundit.....	13
2.5	Sfidat kryesore të zbatimit të këtyre programeve gjatë 3 viteve të fundit.....	15
2.6	Histori suksesi gjatë 3 viteve të fundit	16
2.7	Cili ka qënë instrumenti më i suksesshëm i përdorur gjatë 3 viteve të fundit?.....	17
2.8	Kanalet më efektive të informacionit.....	18
2.9	Ndërhyrjet në të ardhmen në fushën e BGJ, DHnGV, DHF	19
III.	SHTOJCA A: LISTA E PERSONAVE TË INTERVISTUAR.....	23

I. TË DHËNAT SASIORE TË VLERËSIMIT AFATMESËM

1.1 Profili i zonave të projektit mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF

Të dhënat e mëposhtme përfshijnë përgjigjet e mbledhura nga anketimi i 1260 individëve - gra, vajza, burra, djem dhe të tjerë, të moshave 15 – 64 vjeç, përgjatë vitit 2019, në Qarkun e Elbasanit dhe bashkitë e Durrësit, Kamzës, Korçës, Shkodrës, Tiranës dhe Vlorës, në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë dhe persona nga komunitetet e marginalizuara (Rome, Egjiptiane, personat me aftësi të kufizuara, dhe persona LGBTI).



Njohja e Ligjit/ Informacion rreth Ligjit/ Familjariteti me Ligjin

- **77% e të anketuarve** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi barazinë gjinore, **83% e tyre** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.
- **1 në 3 e të anketuarve** nuk ishin të informuar se dhuna jo-fizike dhe dhuna e formave të tjera janë të dënueshme me ligj.
- **71.4% e të anketuarve** besonte që një person do të dënohej për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me forcë me bashkëshorten/partneren e vet.

Perceptimet e roleve gjinore

- **34.7% e të anketuarve** besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë duhet të ndjekin mundësitë e karrierës. Konkretisht:
 - **60% e të anketuarve nga komuniteti Rom/Egjiptian** besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake.
 - **38% e individëve me aftësi të kufizuara** besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake.
- Më shumë se 1 në 4 gra të anketuara bien dakord që gratë duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me bashkëshortët e tyre pavarësisht nga dëshira e tyre. Në mes të anketuarave Rome/ Egjiptiane ky besim është edhe më i lartë, konkretisht 1 në 2 të anketuara Rome/ Egjiptiane. Kjo e fundit lidhet ngushtë edhe me fenomenin e martesave të hershme, që fatkeqësisht mbetet ende sfida për t'u adresuar në shoqërinë shqiptare.

- Në lidhje me kontrollin mbi financa e grave, 1 në 3 burra të anketuar; dhe më shumë se 1 në 4 gra të anketuara besojnë që të ardhurat e gruas janë pronë e partnerit.

Qëndrimet ndaj dhunës kundër grave

- 1 në 3 burra të anketuar dhe 1 në 6 gra të anketuara pohojnë se pabesia (tradhëtia) është një “arsye e mirë/ mjaftueshme” që partnerët meshkuj të godasin partneren e tyre. Për më tepër, 21.9% e burrave të anketuar dhe 9.3% e grave të anketuara besojnë gjithashtu se edhe vetëm dyshimi për tradhëti bashkëshortore përbën një “arsye të mirë” që një burrë të godasë partneren e vet.
- **Dhuna në familje perceptohet si një çështje private që duhet të adresohet brenda familjes.** Më shumë se çereku i të anketuarve pranojnë se gratë e abuzuara nuk duhet të kërkojnë ndihmë në polici.

Gatishmëria për të parandaluar ose raportuar dhunën

- **Të anketuarit ishin në mënyrë domethënëse më pak të gatshëm për të ndihmuar në parandalimin e dhunës kundër anëtarëve të komuniteteve të marginalizuara**, vetëm 48% e burrave të anketuar dhe 59.7% e grave të anketuara treguan gatishmëri për të ndërmarrë masa për të parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI.

Kanalet e zakonshme për të dhënë mesazhe për DHNGV dhe barazinë gjinore

- Spotet televizive/ emisionet/ debatet (41%), materialet promovuese të tilla si fletëpalosjet, posterat, tabelat publicitare (32%), media sociale (25%) dhe radio (24%) janë kanalet më efikase për të shpërndarë informacion që lidhet me parandalimin e dhunës kundër grave.

1.2 Profili i Bashkisë Durrës mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF

Të dhënat e mëposhtme përfshijnë përgjigjet e mbledhura nga anketimi i 176 individëve - gra, vajza, burra, djem dhe të tjerë, të moshave 15 – 64 vjeç, përgjatë vitit 2019, në bashkinë e Durrësit, në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë dhe persona nga komunitetet e marginalizuara (Rome, Egjiptiane dhe personat me aftësi të kufizuara).



Njohja e Ligjit/ Informacion rreth Ligjit/ Familjariteti me Ligjin

- **81.3% e të anketuarve** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji për barazinë gjinore, **98.3% e tyre** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.
- **11% e të anketuarve** nuk ishin të informuar se dhuna jo-fizike dhe dhuna e formave të tjera janë të dënueshme me ligj.
- **85.8% e të anketuarve** besonte që një person do të dënohej për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me forcë me bashkëshorten/partneren e vet.

Perceptimet e roleve gjinore

- **21%** e të anketuarve besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë duhet të ndjekin mundësitë e karrierës. Konkretisht:
 - **60% e të anketuarve nga komuniteti Rom/Egjiptian** besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake.
 - **60% e individëve me aftësi të kufizuara** besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake.
- **4.5%** e grave dhe **13.6%** e burrave të anketuar bien dakord që gratë duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me bashkëshortët e tyre pavarësisht nga dëshira e tyre.
- *Në lidhje mbi kontrollin mbi financa e grave*, **1 në 4** burra të anketuar; dhe **1 në 6** gra të anketuara besojnë që të ardhurat e guas

janë pronë e partnerit.

Qëndrimet ndaj dhunës kundër grave

- **1 në 3** burra të anketuar dhe **1 në 11** gra të anketuara pohojnë se pabesia (tradhëtia) është një “arsye e mirë/ mjaftueshme” që partnerët meshkuj të godasin partneren e tyre. Për më tepër, **10.2%** e burrave të anketuar dhe **2.2%** e grave të anketuara besojnë gjithashtu se edhe vetëm dyshimi për tradhëti bashkëshortore përbën një “arsye të mirë” për një burrë për të goditur partneren e vet.
- **Dhuna në familje perceptohet si një çështje private që duhet të adresohet brenda familjes.** **17%** e të anketuarve pranojnë se gratë e abuzuara nuk duhet të kërkojnë ndihmë në polici.

Gatishmëria për të parandaluar ose raportuar dhunën

- **Të anketuarit ishin në mënyrë domethënëse më pak të gatshëm për të ndihmuar në parandalimin e dhunës kundër anëtarëve të komuniteteve të marginalizuara**, vetëm **40.9%** e burrave të anketuar dhe **59%** e grave të anketuara treguan gatishmëri për të ndërmarrë masa për të parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI.

Kanalet e zakonshme për të dhënë mesazhe për DHNGV dhe barazinë gjinore

- **Spotet televizive/ emisionet/ debatet (48.5%), materialet promovuese të tilla si fletëpalosjet, posterat, tabelat publicitare (18.5%), media sociale (82.4%) dhe radio (20.5%) janë kanalet më efektive për të shpërndarë informacion që lidhet me parandalimin e dhunës kundër grave.**

1.3 Profili i Qarkut Elbasan mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF

Të dhënat e mëposhtme përfshijnë përgjigjet e mbledhura nga anketimi i 248 individëve - gra, vajza, burra, djem dhe të tjerë, të moshave 15 – 64 vjeç, përgjatë vitit 2019, në Qarkun e Elbasanit në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë dhe persona nga komunitetet e marginalizuara (Rome, Egjiptiane dhe personat me aftësi të kufizuara).



Njohja e Ligjit/ Informacion rreth Ligjit/ Familjariteti me Ligjin

- **87.9% e të anketuarve** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji për barazinë gjinore, **97.6% e tyre** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.
- **10% e të anketuarve** nuk ishin të informuar se dhuna jo-fizike dhe dhuna e formave të tjera janë të dënueshme me ligj.
- **91% e të anketuarve** besonte që një person do të dënohej për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me forcë me bashkëshorten/partneren e vet.

Perceptimet e roleve gjinore

- **32%** e të anketuarve besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë duhet të ndjekin mundësitë e karrierës. Konkretisht:
- Afërsisht 6.5 % e grave të anketuara bien dakord që gratë duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me bashkëshortët e tyre pavarësisht nga dëshira e tyre. Në mes të anketuarave Rome/ Egjiptiane ky besim është edhe më i lartë, konkretisht 1 në 2 të anketuara Rome/ Egjiptiane.
- Në lidhje me kontrollin mbi financat e grave, 1 në 3 burra të anketuar; dhe më shumë se 1 në 3 gra të anketuara besojnë që të ardhurat e gruas janë pronë e partnerit.

Qëndrimet ndaj dhunës kundër grave

- 2.4% e burrave të anketuar dhe 7.3% gra të anketuara pohojnë se pabesia (tradhëtia) është një “arsye e mirë/ mjaftueshme” që partnerët meshkuj të godasin partneren e tyre. Për më tepër, 8.9 % e burrave të anketuar dhe 5.6 % e grave të anketuara besojnë gjithashtu se edhe vetëm dyshimi për tradhëti bashkëshortore përbën një “arsye të mirë” për një burrë për të goditur partneren e tij.
- **Dhuna në familje perceptohet si një çështje private që duhet të adresohet brenda familjes.** Më shumë se çereku i të anketuarve pranojnë se gratë e abuzuara nuk duhet të kërkojnë ndihmë në polici.

Gatishmëria për të parandaluar ose raportuar dhunën

- **Të anketuarit ishin shumë më pak të gatshëm të ndihmojnë në parandalimin e dhunës kundër anëtarëve të komuniteteve të marginalizuara**, mbi 40% e burrave të anketuar dhe 30 % e grave të anketuara treguan gatishmëri për të ndërmarrë masa për të parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI.

Kanalet e zakonshme për të dhënë mesazhe për DHNGV dhe barazinë gjinore

- Spotet televizive/ emisionet/ debatet (58.4%), materialet promovuese të tilla si fletëpalosjet, posterat, tabelat publicitare (25.4%), media sociale (66%) dhe radio (40%) janë kanalet më efektive për të shpërndarë informacion që lidhet me parandalimin e dhunës kundër grave.

1.4 Profili i Bashkisë Kamëz mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF

Të dhënat e mëposhtme përfshijnë përgjigjet e mbledhura nga anketimi i **69 individëve** - gra, vajza, burra, djem dhe të tjerë, të moshave **15 – 64 vjeç**, përgjatë vitit **2019**, në **Bashkinë e Kamzës** në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë dhe persona nga komunitetet e marginalizuara (personat me aftësi të kufizuara).



Njohja e Ligjit/ Informacion rreth Ligjit/ Familjariteti me Ligjin

- **97.1% e të anketuarve** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi barazinë gjinore, dhe pothuajse të gjithë, **97.1% e tyre** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.
- **Rreth 28% e të anketuarve** nuk ishin të ndërgjegjshëm se dhuna jofizike dhe dhuna e formave të tjera ishin të dënueshme me ligj; Vihet re se në Bashkinë e Kamzës rreth **60% e të anketuarve** nuk e dinin që *dhuna psikologjike është një nga format e DHNGV që dënohet me ligj*.
- **93% e të anketuarve** besonte që një person do të dënohej për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me forcë me bashkëshorten/partneren e vet.

Perceptimet e roleve gjinore

- **20% e të anketuarve** besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë duhet të ndjekin mundësitë e karrierës.
- Afërsisht 1 në 6 gra të anketuara bien dakord që gratë duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me bashkëshortët e tyre pavarësisht nga dëshira e tyre.
- *Në lidhje mbi kontrollin mbi financa e grave*, në mënyrë të dukshme, 1 në 5 burra të anketuar; dhe 1 në 2 gra të anketuara besojnë që të ardhurat e gruas janë pronë e partnerit. *Në këtë raport bie në sy që burrat në raport me gratë janë më tolerant për sa i përket menaxhimit të ardhurave nga vetë gruaja.*

Qëndrimet ndaj dhunës kundër grave

- 1 në 5 burra të anketuar dhe 11% gra të anketuara pohojnë se pabesia (tradhëtia) është një “arsye e mirë/ mjaftueshme” për partnerët meshkuj për të goditur partneren e tyre femër. Për më tepër, 20.9% e burrave të anketuar dhe 20% e grave të anketuara besojnë gjithashtu se edhe vetëm dyshimi për tradhëti bashkëshortore përbën një “arsye të mirë” për një burrë për të goditur partneren e vet.
- **Dhuna në familje perceptohet si një çështje private që duhet të adresohet brenda familjes.** Më shumë se 20% e të anketuarve pranojnë se gratë e abuzuara nuk duhet të kërkojnë ndihmë në polici.

Gatishmëria për të parandaluar ose raportuar dhunën

- **Të anketuarit ishin në mënyrë domethënëse më pak të gatshëm për të ndihmuar në parandalimin e dhunës kundër anëtarëve të komuniteteve të marginalizuara**, vetëm 18% e burrave të anketuar dhe 11% e grave të anketuara treguan gatishmëri për të ndërmarrë masa për të parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI.

Kanalet e zakonshme për të dhënë mesazhe për DHNGV dhe barazinë gjinore

- Spotet televizive/ emisionet/ debatet (29%), materialet promovuese të tilla si fletëpalosjet, posterat, tabelat publicitare (2.4%), media sociale (18%) dhe radio (1.4%) janë kanalet më efektive për të shpërndarë informacion që lidhet me parandalimin e dhunës kundër grave.

1.5 Profili i Bashkisë Korçë mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF

Të dhënat e mëposhtme përfshijnë përgjigjet e mbledhura nga anketimi i 78 individëve - gra, vajza, burra, djem dhe të tjerë, të moshave 15 – 64 vjeç, përgjatë vitit 2019, në Bashkinë e Korçës në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë dhe persona nga komunitetet e marginalizuara (Rome, Egjiptiane dhe personat me aftësi të kufizuara).



Njohja e Ligjit/ Informacion rreth Ligjit/ Familjariteti me Ligjin

- **70.5% e të anketuarve** kishin njohuri për ekzistencën e një ligji mbi barazinë gjinore, **78.2% e tyre** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.
- **58% e të anketuarve** nuk ishin të ndërgjegjshëm se dhuna jo-fizike dhe dhuna e formave të tjera ishin të dënueshme me ligj.
- **60.3% e të anketuarve** besonte që një person do të dënohej për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me forcë me bashkëshorten/partneren e vet.

Perceptimet e roleve gjinore

- **21.8% e të anketuarve** besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë duhet të ndjekin mundësitë e karrierës. Konkretisht:
 - **20% e të anketuarve nga komunitetit Rom/Egjiptian** besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake.
 - **50% e individëve me aftësi të kufizuara** besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake.
- Më shumë se 1 në 3 gra të anketuara bien dakord që gratë duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me bashkëshortët e tyre pavarësisht nga dëshira e tyre. Në mes të anketuarave Rome/ Egjiptiane ky besim është regjistruar më i ulët, konkretisht 1 në 6 të anketuar Rome/ Egjiptiane.
- *Në lidhje mbi kontrollin mbi financat e grave*, në mënyrë të dukshme,

1 në 3 burra të anketuar; dhe më shumë se 1 në 5 gra të anketuara besojnë që të ardhurat e gruas janë pronë e partnerit.

Qëndrimet ndaj dhunës kundër grave

- Afërsisht 1 në 2 burra të anketuar dhe 1 në 6 gra të anketuara pohojnë se pabesia (tradhëtia) është një “arsye e mirë/ mjaftueshme” për partnerët meshkuj për të goditur partneren e tyre femër. Për më tepër, 28.2% e burrave të anketuar dhe 10.3% e grave të anketuara besojnë gjithashtu se edhe vetëm dyshimi për tradhëti bashkëshortore përbën një “arsye të mirë” për një burrë për të goditur partneren e vet.
- **Dhuna në familje perceptohet si një çështje private që duhet të adresohet brenda familjes.** 20.5% e të anketuarve pranojnë se gratë e abuzuara nuk duhet të kërkojnë ndihmë në polici.

Gatishmëria për të parandaluar ose raportuar dhunën

- **Të anketuarit meshkuj ishin në mënyrë domethënëse më pak të gatshëm për ndihmuar në parandalimin e dhunës kundër anëtarëve të komuniteteve të marginalizuara**, vetëm 41% e burrave të anketuar dhe 84.6% e grave të anketuara treguan gatishmëri për të ndërmarrë masa për të parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI.

Kanalet e zakonshme për të dhënë mesazhe për DHNGV dhe barazinë gjinore

- Spotet televizive/ emisionet/ debatet (42%), materialet promovuese të tilla si fletëpalosjet, posterat, tabelat publicitare (21%), media sociale (48.7%) dhe radio (33%) janë kanalet më efektive për të shpërndarë informacion që lidhet me parandalimin e dhunës kundër grave.

1.6 Profili i Bashkisë Shkodër mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF

Të dhënat e mëposhtme përfshijnë përgjigjet e mbledhura nga anketimi i **118 individëve** - gra, vajza, burra, djem dhe të tjerë, të moshave **15 – 64 vjeç**, përgjatë vitit **2019**, në **Bashkinë e Shkodrës**, në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë dhe persona nga komunitetet e marginalizuara (Rome, Egjiptiane, dhe personat me aftësi të kufizuara).



Njohja e Ligjit/ Informacion rreth Ligjit/ Familjariteti me Ligjin

- **70.5% e të anketuarve** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi barazinë gjinore, **78.2% e tyre** kishin njohuri mbi ekzistencën e një ligji mbi dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.
- **Rreth 39% e të anketuarve** nuk ishin të ndërgjegjshëm se dhuna jo-fizike dhe dhuna e formave të tjera ishin të dënueshme me ligj.
- **82.1% e të anketuarve** besonte që një person do të dënohej për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me forcë me bashkëshorten/partneren e vet.

Perceptimet e roleve gjinore

- **21.8% e të anketuarve** besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë duhet të ndjekin mundësitë e karrierës. Konkretisht:
 - **60% e të anketuarve nga komunitetit Rom/Egjiptian** besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake.
- Më shumë se 1 në 5 gra të anketuara bien dakord që gratë duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me bashkëshortët e tyre pavarësisht nga dëshira e tyre. Në mes të anketuarave Rome/ Egjiptiane ky besim është i lartë në të gjithë Romët dhe Egjiptianët e anketuar.
- Në lidhje me kontrollin mbi financat e grave, në mënyrë të dukshme, 1 në 3 burra të anketuar; dhe më pak se 1 në 3 gra të anketuara besojnë që të ardhurat e gruas janë pronë e partnerit.

Qëndrimet ndaj dhunës kundër grave

- 1 në 3 burra të anketuar dhe 1 në 4 gra të anketuara pohojnë se pabesia (tradhëtia) është një “arsye e mirë/ mjaftueshme” për partnerët meshkuj për të goditur partneren e tyre femër. Për më tepër, 13.6% e burrave të anketuar dhe 10.2% e grave të anketuara besojnë gjithashtu se edhe vetëm dyshimi për tradhëti bashkëshortore përbën një “arsye të mirë” për një burrë për të goditur partneren e vet.
- **Dhuna në familje perceptohet si një çështje private që duhet të adresohet brenda familjes.** 20.5% e të anketuarve pranojnë se gratë e abuzuara nuk duhet të kërkojnë ndihmë në polici.

Gatishmëria për të parandaluar ose raportuar dhunën

- **Të anketuarit ishin në mënyrë domethënëse më pak të gatshëm për ndihmuar në parandalimin e dhunës kundër anëtarëve të komuniteteve të marginalizuara**, vetëm 34% e burrave të anketuar dhe 37.3% e grave të anketuara treguan gatishmëri për të ndërmarrë masa për të parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI.

Kanalet e zakonshme për të dhënë mesazhe për DHNGV dhe barazinë gjinore

- Spotet televizive/ emisionet/ debatet (62%), materialet promovuese të tilla si fletëpalosjet, posterat, tabelat publicitare (22%), media sociale (62%) dhe radio (23%) janë kanalet më efektive për të shpërndarë informacion që lidhet me parandalimin e dhunës kundër grave.

1.7 Profili i Bashkisë Tiranë mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF

Të dhënat e mëposhtme përfshijnë përgjigjet e mbledhura nga anketimi i **457 individëve** - gra, vajza, burra, djem dhe të tjerë, të moshave **15 – 64 vjeç**, përgjatë vitit **2019**, në **Bashkinë e Tiranës**, në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë dhe persona nga komunitetet e marginalizuara (Rome, Egjiptiane, personat me aftësi të kufizuara, dhe personave LGBTI).



Njohja e Ligjit/ Informacion rreth Ligjit/ Familjariteti me Ligjin

- **67.6% e të anketuarve** kishin njohuri për ekzistencën e një ligji mbi barazinë gjinore, **65.4% e tyre** kishin njohuri për ekzistencën e një ligji mbi dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.
- **Rreth 36% e të anketuarve** nuk ishin të ndërgjegjshëm se dhuna jo-fizike dhe dhuna e formave të tjera ishin të dënueshme me ligj.
- **56.9% e të anketuarve** besojnë që një person do të dënohej për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me forcë me bashkëshorten/partneren e vet.

Perceptimet e roleve gjinore

- **26.3% e të anketuarve** besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë duhet të ndjekin mundësitë e karrierës. Konkretisht:
 - **Rreth 67% e të anketuarve nga komuniteti Rom/Egjiptian** besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake.
 - **Asnjë prej personave me aftësi të kufizuara** nuk është shprehur se beson se vajzat i përkasin sferës shtëpiake.
 - **Po ashtu, asnjë prej personave LGBTI** nuk është shprehur se beson se vajzat i përkasin sferës shtëpiake.
- Më shumë se 1 në 6 gra të anketuara bien dakord që gratë duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me bashkëshortët e tyre pavarësisht nga dëshira e tyre. *Në mes të anketuarave Rome/ Egjiptiane ky besim është i lartë.*

- *Në lidhje me kontrollin mbi financa e grave*, në mënyrë të dukshme, më shumë se 1 në 3 burra të anketuar; dhe më pak se 1 në 6 gra të anketuara besojnë që të ardhurat e gruas janë pronë e partnerit.

Qëndrimet ndaj dhunës kundër grave

- Më shumë se 1 në 3 burra të anketuar dhe më pak se 1 në 6 gra të anketuara pohojnë se pabesia (tradhëtia) është një “arsye e mirë/ mjaftueshme” për partnerët meshkuj për të goditur partneren e tyre femër. Për më tepër, 26.4% e burrave të anketuar dhe 9.2% e grave të anketuara besojnë gjithashtu se edhe vetëm dyshimi për tradhëti bashkëshortore përbën një “arsye të mirë” për një burrë për të goditur partneren e vet.
- **Dhuna në familje perceptohet si një çështje private që duhet të adresohet brenda familjes.** 19.9% e të anketuarve pranojnë se gratë e abuzuara nuk duhet të kërkojnë ndihmë në polici.

Gatishmëria për të parandaluar ose raportuar dhunën

- **Të anketuarit ishin në mënyrë domethënëse më pak të gatshëm për të ndihmuar në parandalimin e dhunës kundër anëtarëve të komuniteteve të marginalizuara**, vetëm 29.5% e burrave të anketuar dhe 44.7% e grave të anketuara treguan gatishmëri për të ndërmarrë masa për të parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI.

Kanalet e zakonshme për të dhënë mesazhe për DHnGV dhe barazinë gjinore

- Spotet televizive/ emisionet/ debatet (53%), materialet promovuese të tilla si fletëpalosjet, posterat, tabelat publicitare (35.5%), media sociale (47.5%) dhe radio (28.5%) janë kanalet më efektive për të shpërndarë informacion që lidhet me parandalimin e dhunës kundër grave.

1.8 Profili i Bashkisë Vlorë mbi perceptimet për BGJ, DHnGV, DHF

Të dhënat e mëposhtme përfshijnë përgjigjet e mbledhura nga anketimi i **114 individëve** - gra, vajza, burra, djem dhe të tjerë, të moshave **15 – 64 vjeç**, përgjatë vitit **2019**, në **Bashkinë e Vlorës**, në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë dhe persona nga komunitetet e marginalizuara (Rome, Egjiptiane dhe personat me aftësi të kufizuara).



Njohja e Ligjit/ Informacion rreth Ligjit/ Familjariteti me Ligjin

- **93% e të anketuarve** kishin njohuri për ekzistencën e një ligji mbi barazinë gjinore, **94.7% e tyre** kishin njohuri për ekzistencën e një ligji mbi dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.
- **Rreth 22% e të anketuarve** nuk ishin të ndërgjegjshëm se dhuna jo-fizike dhe dhuna e formave të tjera ishin të dënueshme me ligj.
- **61.4% e të anketuarve** besonte që një person do të dënohej për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me forcë me bashkëshorten/partneren e vet.

Perceptimet e roleve gjinore

- **20%** e të anketuarve besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake, ndërsa djemtë duhet të ndjekin mundësitë e karrierës. Konkretisht:
 - **60% e të anketuarve nga komunitetit Rom/Egjiptian** besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake.
 - **57% e individëve me aftësi të kufizuara** besojnë se vajzat i përkasin sferës shtëpiake.
- Afërsisht 1 në 3 gra të anketuara bien dakord që gratë duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me bashkëshortët e tyre pavarësisht nga dëshira e tyre. Në mes të anketuarave Rome/ Egjiptiane ky besim është më i lartë, konkretisht 83% e të anketuarave Rome/ Egjiptiane.
- Në lidhje me kontrollin mbi financat e grave, afërsisht 1 në 2 burra të anketuar; dhe afërsisht 1 në 4 gra të anketuara besojnë që të ardhurat

e gruas janë pronë e partnerit.

Qëndrimet ndaj dhunës kundër grave

- 78% e burrave të anketuar dhe 44.8% e grave të anketuara pohojnë se pabesia (tradhëtia) është një “arsye e mirë/ mjaftueshme” për partnerët meshkuj për të goditur partneren e tyre femër. Për më tepër, 60.7% e burrave të anketuar dhe 20.7% e grave të anketuara besojnë gjithashtu se edhe vetëm dyshimi për tradhëti bashkëshortore përbën një “arsye të mirë” për një burrë për të goditur partneren e vet.
- **Dhuna në familje perceptohet si një çështje private që duhet të adresohet brenda familjes.** Më shumë se 34% e të anketuarve pranojnë se gratë e abuzuara nuk duhet të kërkojnë ndihmë në polici.

Gatishmëria për të parandaluar ose raportuar dhunën

- **Të anketuarit ishin në mënyrë domethënëse më pak të gatshëm për të ndihmuar në parandalimin e dhunës kundër anëtarëve të komuniteteve të marginalizuara**, vetëm 7.1% e burrave të anketuar dhe 13.8% e grave të anketuara treguan gatishmëri për të ndërmarrë masa për të parandaluar dhunën ndaj personave LGBTI.

Kanalet e zakonshme për të dhënë mesazhe për DHnGV dhe barazinë gjinore

- Spotet televizive/ emisionet/ debatet (63%), materialet promovuese të tilla si fletëpalosjet, posterat, tabelat publicitare (14.3%), media sociale (58.8%) dhe radio (19.7%) janë kanalet më efektive për të shpërndarë informacion që lidhet me parandalimin e dhunës kundër grave.

II. TË DHËNAT CILËSORE TË VLERËSIMIT AFATMESËM

2.1 Grupet e synuara përgjatë 3 viteve të fundit nga programet e implementuara

Në përgjithësi programet e implementuara nga organizatat apo institucionet e intervistuar në fushën e çështjeve të BGJ, DHnGV dhe DHF në vend kanë si grupe kryesore të synuara *vajzat dhe gratë, të mbijetuara të dhunës në familje, burra dhe gra, të rinj, ofruar shërbimesh, organizatat e shoqërisë civile*. Programet apo ndërhyrjet e institucioneve shtetërore kanë fokus më të gjerë, për mbrojtjen e të gjithë grupeve, pa asnjë lloj diskriminimi. Në grupet e synuara janë edhe *burrat/ djemtë* dhunues të cilëve u ofrohet asistencë psikologjike për rehabilitimin e tyre. Më në veçanti, ka edhe programe që adresojnë probleme të dhunës ndaj grave në grupet *PAK, Romë/Egjyptianë, apo LGBTI, si dhe viktimat e dhunës seksuale, trafikimit dhe gratë e zonave rurale/ marxhinalizuara* të cilat synohen të fuqizohen ekonomikisht nëpërmjet programeve të ndryshme. Ajo që vihet re është se ka programe që synojnë të njëjtat grupe, por ndërhyrjet e tyre kufizohen në zona të caktuara.

Me *të rinjtë* bëhet punë ndërgjegjësuese, si edhe angazhohen në komunitet kundër dhunës në familje nëpërmjet programeve që synojnë edukimin e të rinjve. Target grup janë edhe *punonjësit e institucioneve shtetërore*, ata që zbatojnë politikën, policia e shtetit, profesionistët ose ofruarët e shërbimeve kryesisht në nivel vendor duke përfshirë këtu ata të fushës sociale, shëndetësisë, të arsimit, policisë, drejtësisë, shoqërisë civile, që kanë në fokus të punës së tyre ofrimin e shërbimeve sociale për parandalimin e dhunës në familje, por edhe adresimin e problemeve të viktimave të dhunës në familje, kryesisht për gratë. Për këtë target grup ofrohen ngritje kapacitetesh.

Një tjetër grup i synuar në programet e organizatave të intervistuar është *ai i grave në vendimmarrje, gratë këshilltare të zgjedhura, gratë parlamentare, gratë udhëheqëse, gratë në akademi, burrat në poste drejtuese* të angazhuar në çështje të barazisë gjinore, aktivistët e shoqërisë civile (gra dhe burra) që punojnë në barazinë gjinore dhe barazinë gjinore në vendimmarrje, punonjësit gjinorë në ministri dhe institucione të tjera shtetërore, OJF që kanë në fokus barazinë gjinore, të rinj që merren me barazinë gjinore.

2.2 Kanalet më të përdorur të informacionit

Mediat e ndryshme janë përmendur ndër kanalet më të përdorur të informacionit. Përfaqësuesit e organizatave deklaruan se përdoren si *mediat sociale, edhe media vizive dhe ajo audio*. Mediat sociale më të përdorura janë facebook, instagram, twitter dhe youtube. Ndër mediat vizive veçohen kanalet publike dhe ato kombëtare, por sigurisht që janë përdorur edhe mediat vendore për të përçuar mesazhet dhe për të targetuar çështje të ndryshme të lidhura me dhunën. Pjesëmarrja në programet televizive, intervistat televizive mbi çështjet në fjalë, programet radiofonike, shfaqja e dokumentarëve mbi DHF. Shfaqja e dokumentarëve dhe diskutimi për të më pas është një praktikë që përdoret disa raste në takimet në komunitet, shkolla, etj., dhe në organizimin e forumeve të hapura.

Në luftën kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave janë përdorur edhe *video mesazhet* ku janë përfshirë shumë aktorë të njohur për publikun shqiptar, janë ftuar shumë gra që punojnë në profesione të ndryshme duke dhënë mesazhe për parandalimin e dhunës ndaj gruas dhe mbrojtjen e fëmijëve. Këto video mesazhe shpërndahen në media të ndryshme, online dhe vizive. Shumë prej organizatave të intervistuar kanë realizuar video sensibilizuese për çështje të ndryshme, si për shembull, një videomesazh për stereotipet gjinore nga këndvështrimi i djemve me titull “Jemi të barabartë”, “Roli i baballarëve për rritjen e fëmijëve”, apo video të shkurtra në lidhje me gjetjet e studimeve të ndryshme.

Të gjithë organizatat përdorin edhe *faqen e internetit* si kanal të përhershëm komunikimi të mesazheve dhe të aktiviteteve të tyre. Ndër metodat më të zakonshme të shpërndarjes së informacionit janë edhe *takimet informuese në komunitet*, me nxënës dhe mësues në shkolla, takime me gra dhe vajza të komunitetit, forume diskutimi me aktorë të ndryshëm përgjegjës, fushata ndërgjegjësuese me pjesëmarrjen e të rinjve, pjesëmarrje në tryeza të rrumbullakëta, mesazhe sensibilizuese në rrjetet sociale, veprimtari lobuese, takime me titullarë të institucioneve etj.

Gjithashtu, janë organizuar edhe *fushata informuese e ndërgjegjësuese në komunitet* sidomos me gratë, veçanërisht në zonat rurale. Takimet informuese dhe ndërgjegjësuese në komunitet janë ndër më të përdorurat. Ndër materialet e printuara janë përdorur fletëpalosje dhe materiale të tjera promovionale

Disa nga organizatat e intervistuar organizojnë *konferenca kombëtare vjetore*. Në këto konferenca marrin pjesë aktorët kyç në trajtimin e çështjes së dhunës në familje dhe synohet një mbulim i madh mediatik, çka jep rezultat në raportimin në rritje të rasteve të dhunës.

Një kanal inovativ është *këshillimi online*, i cili ka nisur në mënyrë spontane nga mesazhet që gratë dhe vajzat kanë nisur në rrjetet sociale, duke ngritur kështu një shërbim që ofrohet online. Manifestimet për të tërhequr vëmendjen e publikut janë më pak të përdorura si mjete të zakonshme informimi e ndërgjegjësimi, por jo pak të përdorura për çështje të nxehta të momentit.

Përdorimi i këtyre mjeteve të listuara më sipër ndryshon në varësi të grupit të synuar. Për shembull, në rastin e informimit të grave rome janë organizuar takime në grup, takime derë më derë, seanca informimi dhe trajnime.

2.3 Monitorimi dhe vlerësimi i programeve

Të gjithë programet e implementuara nga organizatat e intervistuar i nënshtrohen një procesi strikt monitorimi, të brendshëm dhe/ose të jashtëm. Zakonisht, që në konceptim të programit ndërtohen tabela për menaxhim të bazuar në rezultate. Nëpërmjet monitorimit organizatat vlerësojnë impaktin që kanë programet që ato implementojnë në zonat /dhe target grupet që kanë në fokus. Raportet e monitorimit dhe vlerësimit për çdo projekt janë përgjithësisht pjesë e raportimit të projekteve. Në rastet kur nuk ka monitorime apo vlerësime të jashtme, organizatat bëjnë monitorimin e tyre, si pjesë e analizës së punës së bërë dhe matjes së performancës.

Institucionet shtetërore çdo vit hartojnë një raport monitorimi në kuadër të zbatimit të objektivave të Strategjisë Kombëtare ku për çdo fushë nxirren problematikat dhe sfidat për të ardhmen. Zakonisht raportet e monitorimit dhe vlerësimit të programeve apo strategjive kombëtare gjenden online.

2.4 Praktikrat e sukseshme të identifikuara nga zbatimi i programeve/ fushatave për BGJ, DHnGV dhe DHF gjatë 3 viteve të fundit

Përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë listoi *ngritjen e Zyrës së Koordinimit kundër Dhunës në Familje dhe Miratimin e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore, 2018-2020*, si dy nga rrjedhojat kryesore të zbatimit të programeve gjatë tri viteve të fundit. Ndërsa përfaqësuesi i Avokatit të Popullit përmendi rekomandime për ndryshime në ligjin “Për përfshirjen e grave e vajzave në këshillat bashkiak” (deri në 50%) si dhe disa ndryshime në ligjin e “Dhunës në familje”.

OJF-të e intervistuar tregojnë se *angazhimi me burrat dhe djemtë dhunues* ka qënë një praktikë e sukseshme dhe risi pasi ata jo vetëm rehabilitohen, por duhet të mbajnë dhe barrën e përgjegjësisë për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore.

Bashkëpunimi me organizata të tjera dhe krijimi i rrjeteve të këtyre organizatave nën qëllime të caktuara, si për shembull kundër dhunës në familje dhe trafikimit, për ofrimin e shërbimeve, për ndërgjegjesimin e komunitetit, janë gjithashtu praktika të mira, pasi puna në rrjet organizatash ofron një koordinim shumë më të mirë të punës dhe rrit numrin e rasteve të referuara. Në kuadër të bashkëpunimit si një praktikë e mirë, është listuar edhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me institucionet shtetërore, pushtetin vendor, njësitë e dhunës/seksionet e ndihmës ekonomike, për të përçuar në komunitet informacionin. Duke ndërtuar urat e bashkëpunimit me njësitë vendore rritet mundësia e përçimit të informacionin në zona më të thella. Ndërveprimi dhe koordinimi i veprimeve mes aktorëve të nivelit qendror, vendor, shoqërisë civile, grupeve të interesit është faktor vendimtar i suksesit të ndërhyrjeve.

Monitorimi i programeve është gjithashtu një nga praktikat e mira të identifikuara, përfshirë monitorimin e brendshëm, por për më tepër monitorimin e institucioneve që ofrojnë shërbime për të mbijetuarat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Monitorimi i mekanizmit të DHF në 6 bashki, në kuadrin e programit të përbashkët me UN Women dhe Aleancën Gjinore për Zhvillim, i cili ka bërë që bashkitë të jenë më llogaridhënëse, mekanizmat të jenë më proaktive e për rrjedhojë më efektive.

Në zbatimin e fushatave ndërgjegjësuese dhe informuese një praktikë e mirë ka qenë ajo e *punës direkte në komunitet*, komunikimit të drejtpërdrejtë me gratë dhe vajzat, sidomos në zonat rurale, me grupet vulnerabël, grupet rome/egjyptiane duke depërtuar sa më pranë tyre. Kjo praktikë ka ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe rritjen e shkallës së raportimit. Puna në komunitet ka qenë një praktikë e suksesshme sidomos në drejtim të ndërgjegjësimit dhe rritjes së raportimeve të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore. Informimi direkt i komunitetit mbi legjislacionet përkatëse, të drejtat që gëzojnë si dhe institucionet ku mund të drejtohen.

Zhvillimi i vazhdueshëm dhe mbulimi mediatik i aktiviteteve të ndërgjegjësimit kundër dhunës me bazë gjinore mund të cilësohen si praktika të suksesshme. Informimi nëpërmjet përdorimit të një numri të lartë kanalesh komunikuese rrit efektivitetin e aktiviteteve të kryera. Fakti që këto aktivitete zhvillohen në mënyrë të organizuar dhe me pjesëmarrje të gjerë të individëve, institucioneve dhe OJF-ve e rrit së tepërmi impaktin e tyre.

Praktika të tjera të suksesshme të identifikuara nga intervistat e realizuara janë:

- Përfshirja e të rinjve në ndërtimin e prototipeve për të prodhuar një instrument ndryshe dhe për të ardhur ndryshe në komunitet nëpërmjet asaj që quhet eksperiencë sociale.
- Përdorimi i artit në dhënien e mesazheve (nëpërmjet shfaqjeve dhe teatrit) ka qenë një tjetër risi që është përdorur dhe ripërdorur në këto 3 vitet e fundit e cila ka pasur sukses.
- Videot me histori/histori sukcesi të cilat janë prodhuar nga shoqëria civile të ideuara për target grupe të ndryshme duke përfshirë dhe gratë/vajzat me AK.
- Nismat advokuese dhe lobuese në bashkëpunim dhe me organizata të tjera që kanë bërë të mundur ndryshimin e legjislacionit për dhunën në familje.
- Ndjekja e rastit deri në fund, pra që gratë/vajzat të kenë dalë nga cikli i dhunës dhe kanë filluar një jetë tjetër.
- Prodhimi i dokumentarit me titull “Nuk ishte fati im dhe dhuna në familje na përket të gjithëve” i cili u përdor në forume të hapura me grupe të ndryshme dhe më pas u shoqërua nga diskutime.
- Ngritja e qendrës pilot LILIUM, e cila është qendra e parë e viktimave të dhunës seksuale dhe përdhunimit.
- Shërbimi i strehëzës tashmë ofrohet në disa bashki ose ndihma ligjore që u jepet grave dhe vajzave.

2.5 Sfidat kryesore të zbatimit të këtyre programeve gjatë 3 viteve të fundit

Sfida me e madhe e organizatave të intervistuar është *financimi*, dhe pas tij *burimet njerëzore*. Për shembull, këshillueset e linjës kombëtare 116 - 117 kanë punuar vullnetarisht për ta mbajtur linjën hapur 24 orë për rreth një vit. Kjo sfidë ende nuk është tejkaluar plotësisht pasi puna vullnetare për disa orë në ditë vazhdon që shërbimi të mos ndërpritet. Po kështu, Bashkia Elbasan që nga viti 2010 ka të emëruar një Nëpunëse të Barazisë Gjinore që luan edhe rolin e Koordinatorës Vendore kundër dhunës në familje, ndërkohë që në Planin e Mbrojtjes Sociale 2016-2020 të kësaj Bashkie, është sugjeruar zgjerimi i “Sektorit të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore”, ku dukshëm vihet re edhe parashikimi për ndarjen e funksioneve të Nëpunës/es së Barazisë Gjinore dhe Koordinator/es Vendor/e kundër dhunës në familje, përmes emërimit të dy personave me kohë të plotë. Por ende nuk ka shtesë në burimet njerëzore të institucionit. Përveç kësaj, është një sfidë e vërtetë adresimi dhe zgjidhja e problemeve të dhunës ndaj grave në bashkitë ku mekanizmat e referimit nuk janë ngritur ende. Deri tani janë ngritur mekanizmat në 40 bashki dhe deri në fund të vitit 2020 duhet të ngrihen në të 61 bashkitë. Një sfidë themelore është *pamundësia e OJF-ve për të ofruar disa shërbime sociale* si; strehëza, këshillime, shërbim ligjor, punësim, etj., që pengojnë realizimin në praktikë të programeve të ndryshme. Mungesa e strehëzave të emergjencës dhe kapacitetet e limituara të atyre ekzistuese përbën një sfidë dhe një barrierë për rritjen e denoncimeve.

Një tjetër sfidë e rëndësishme ka qenë *mungesa e mbështetjes së OJF-ve nga shteti në lidhje me ofrimin e shërbimeve*. Shpesh OJF-të janë tërësisht të varur nga donatorët për ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës dhe në mungesë të fondeve nuk ofrojnë shërbim. Ndodh që për shkak të përmirësimit të treguesve sipas raportimeve nga qeveria shqiptare, donatorët ulin ose eliminojnë mbështetjen e tyre financiare ndërkohë që realiteti në zona të caktuara të vendit është krejt ndryshe. Kështu për shembull, fondet për fuqizimin e grave janë ulur ndjeshëm, si dhe është bërë e vështirë ngritja e fondeve e për rjedhojë dhe zbatimin e aktiviteteve që synojnë fuqizimin ekonomik të grave.

Organizatave që operojnë në këtë fushë e shohin si problem jo vetëm pamundësinë e tyre për të shtuar staf për shkak të financimeve të kufizuara, por problem për funksionimin më të mirë të tyre dhe implementimin më të mirë të programeve, shpesh bëhet *mungesa e burimeve njerëzore në institucionet shtetërore*, si rrjedhojë e së cilës nuk kanë kapacitete për të adresuar si duhet çështjet që kanë nën ngarkim, si për shembull moszbatimin e urdhërave të mbrojtjes ose zbatimin e pjesshëm të tyre.

Në institucionet shtetërore, sfidat kryesore kanë të bëjnë me *nevojën për të përkthyer strategji që janë miratuar zyrtarisht në masa praktike, efektive dhe të mirë-buxhetuara* që kuptohen mirë nga të gjithë partnerët e zhvillimit dhe institucionet shtetërore, me një ndjenjë të përbashkët të pronësisë dhe me qëllim të qëndrueshmërisë.

Sfidë është në shumë raste *mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve* në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore dhe mbrojtjes së të miturve. Kjo ka bërë që sistemi i referimit të rasteve të mos funksionojë si duhet ose raportimet të mos gjejnë mbështetjen e duhur në kohë dhe me masa përkatëse nga strukturat shtetërore. Shpesh, përfshirja e një numri të madh institucioneve në këto fushata krijon vështirësi në organizim. Gjithashtu këto aktivitete kërkojnë mbështetje financiare e cila është e vështirë të sigurohet ndërsa institucionet shtetërore janë të limituar në buxhetin e tyre për trajtimin e këtyre rasteve. Për më tepër, organizatat e intervistuar konsiderojnë si sfida edhe përgjegjshmërinë e institucioneve, pasi jo të gjitha institucionet janë të përgjegjshme në atë që bëjnë, madje ndodh që nëpunësit e tyre të mos jenë njohur me ndryshimet ligjore dhe detyrat që u përcakton ligji.

Pjesëmarrja e ulët e njerëzve në fushata apo aktivitete ndërgjegjësuese. Vihet re se ka një prirje që njerëzit të mos marrin më pjesë fizikisht. Megjithatë raportimi dhe diskutimi i çështjeve të dhunës online është në rritje. Duhet të ketë një mbulim më të madh mediatik të tyre në mënyrë që mesazhi të arrijë tek sa më shumë njerëz.

Një sfidë tjetër është mendësia e mbyllur në komunitet përsa i përket stereotipeve gjinore pavarësisht një pune të mirë ndërgjegjësuere. Këtë e përforcon edhe fakti se për aq kohë sa çështja mbetet në dorë të organizatave dhe ndërhyrjet nuk janë sistemike dhe të integruara, pra të fillojnë nga çerdhet, kopshtet e shkollat, atëherë përpjekjet e organizatave/institucioneve janë afatshkurtra dhe impakti i tyre mbetet modest. Ndryshimi i mendësisë veçanërisht kërkon kohë, ndaj një tjetër sfidë është angazhimi më i madh për përfshirjen e burrave dhe djemve për të qenë edhe ata agjentë ndryshimi. Një nga sfidat përsa i përket takimeve ndërgjegjësuere është përfshirja e ulët e burrave dhe djemve, të cilët e shohin dhunën dhe barazinë si një çështje që i përket grave. Ky është një problem shumë i madh sepse mentaliteti është element rrënjësor për parandalimin e dhunës.

2.6 Histori suksesi gjatë 3 viteve të fundit

- Ministria e Drejtësisë, ka siguruar informacione publike për disponueshmërinë e shërbimeve të ndihmës juridike, edhe në nivelin lokal, përfshirë zonat rurale, duke i publikuar ato në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë, sikurse e përcakton paragrafi 7, i nenit 34, të ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
- Impakt të menjëhershëm ka patur video “Jemi të barabartë” që është bërë nga djemtë për gratë nga rrjeti AWEN.
- Protesta në 8 Mars me titull “protesta e zisë”, realizuar nga rrjeti AWEN, pasi gratë ishin veshur me të zeza për vdekjen e 10 grave në muajt e parë të vitit. Kjo protestë pati shumë impakt në publik. Njëpërmjet kësaj forme proteste, të mbajtjes së zisë, iu drejtua gishti sistemit për atë që po ndodhte me gratë që ishin lënë jashtë dhe braktisur nga shteti.
- Sllogani “Gruaja ka të drejta të barabarta me burrin” është realizuar nga Qendra për të Drejtat e Grave Rome. Tashmë në komunitetin rom pranohen edhe divorcet të cilat më parë ishin të papranueshme. Kjo tregon se ka filluar ndryshimi i mendësisë për çështje që më parë ishin tabu dhe kjo vihet re sidomos tek brezat e rinj.
- Njohja me të gjitha format e dhunës, ku dhuna ekonomike shpesh nuk njihet, apo dhe përdhunimi nuk përkufizohet si i tillë kur ndodh në marrëdhënien midis dy partnerëve, duke informuar dhe ndërgjegjësuar kështu një pjesë të madhe të komunitetit.

Disa nga slloganet më të suksesshme në zona e programe të caktuara janë:

- Sllogani “Mos hesht”, që është për viktimat e dhunës i cili ka pasur një ndikim të menjëhershëm dhe afatgjatë. Telefonatat vazhdojnë dhe vijnë dhe dhënia e shërbimit vazhdon.
- Sllogani “Bëhu burrë” për burrat dhe djemtë është i suksesshëm. Follow-up me të rinjtë që angazhohen në këtë projekt tregon se janë ndryshuar jetë burrash/djemsh dhe mendësitë e tyre, të cilët pas programit të rehabilitimit janë kthyer sërish në familjet e tyre.
- “Fund dhunës”,
- “Më dëgjo dhe mua” (hear me too),
- “Telefono 112/129”,
- “Kur shfaqet dhuna njerëzorja vdes”,
- “Jepi zë heshtjes, denoncoje dhunën”,
- “Unë jam super grua”,
- “Dhuna në familje na përket të gjithëve”,
- “Ndal dhunën kundër gruas”,
- “Stop dhunën ndaj grave”,
- “Më dëgjo dhe mua, bëje botën portokalli”
- “Thuaj Jo Diskriminimit”,
- “Djemtë dhe burrat pjese e zgjidhjes”,
- “Thyej Heshtjen”.

2.7 Cili ka qënë instrumenti më i suksesshëm i përdorur gjatë 3 viteve të fundit?

OJF-të e intervistuarat kanë qënë në mënyrë të vazhdueshme në kontakt me strukturat përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore dhe kanë lobuar për përmirësimin e praktikave dhe minimizimin e problematikave të konstatuara. Ato kanë asistuar edhe në hartimin e strategjisë kombëtare të BGJ, ku instrumenti i përdorur është vlerësimi i strategjisë pararendëse për të evidentuar sukseset, sfidat dhe dështimet dhe për t'i marrë ato në konsideratë në hartimin e strategjisë së re.

Instrumentet e përdorura janë të shumëllojshme dhe gjykimi mbi suksesin e tyre është në varësi të qëllimit. Për shembull në lidhje me përmirësimin e legjislacionit kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunën në familje, instrumenti më i suksesshëm i OJF-ve ka qënë *lobimi, mbështetja teknike dhe advokacia* në lidhje me të. OJF-të e intervistuarat kanë dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm në amendimin e Ligjit “Për masa ndaj dhunës në mardhëniet familjare” gjatë vitit 2018, në miratimin e akteve nënligjore për zbatim të këtij ligji, udhëzimet e përbashkëta të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Brendshme mbi Formularin e Vlerësimit të Riskut dhe lëshimin e Urdhërit për Masat paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme nga policia e shtetit, dhënien e rekomandimeve në hartimin e Ligjit “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ku këto rekomandime kanë qënë të lidhura me nevojën për trajtimin me përparësi të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Gjithashtu, OJF-të kanë kontribuar në hartimin e Ligjit “Për strehimin social” dhe ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi” si dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre, me qëllim përafrimin e disa prej dispozitave të këtyre ligjeve me nevojat e viktimave/të mbijetuarave nga dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje. Koordinimi i palëve të interesit i kombinuar me ofrimin e ekspertizës, ngritjen e kapaciteteve dhe studimin e thelluar të fenomenit janë instrumente të suksesshëm të organizatave ndërkombëtare.

Ndryshimet kryesore ligjore dhe vendimet e Këshillit të Ministrave, si instrumenta për të përmirësuar situatën në lidhje me dhunën me bazë gjinore, dhe jo vetëm, janë si më poshtë:

- VKM nr. 110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuarat për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”;
- VKM nr. 55, datë 6.2.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuarat për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”;
- VKM nr. 1, datë 6.3.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 4, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”;
- Udhëzimi nr.1 datë 8.3.2019, i Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”;
- Udhëzimi nr.2, datë 25.3.2019, i Ministrit të Drejtësisë “Për procedurat, periodicitetin dhe rregullat për verifikimin e rrethanave për kthimin e përfitimeve”;
- Urdhri nr.225 datë 25.3.2019, i Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”;
- Urdhri nr.226 datë 25.3.2019, i Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”;
- Udhëzimi nr.6 datë 20.8.2019, i Ministrit të Drejtësisë “Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtimi në rastin e dhënies së ndihmës juridike”.

- Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare² (ndryshuar me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, nr.10 329, datë 30.9.2010, 47/2018, datë 23.7.2018), citon në nenin 13/1 Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme (shtuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018).
- “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje” nga Komisioni i policisë që shoqërohet me lëshimin e “Urdhrit për Marrjen e Masave Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme”.

Shpërndarja e informacionit konsiderohet si një instrument i rëndësishëm, përfshirë fushatat ndërgjegjëse, fushatat me radio dhe ato sensibilizuese online, nëpërmjet kontaktit direkt me njerëzit në komunitet, sidomos në zonat rurale, me fokus grupe, workshope, ekspozita, etj. OJF-të kanë bërë një përshtatje të informacionit duke prodhuar video për personat që nuk dëgjojnë apo materiale për personat që nuk shikojnë (shkruar me alfabetin përkatës). Janë prodhuar gjithashtu guida apo udhëzues për personat që nuk shikojnë.

Trajnimet, sesionet informuese dhe ofrimi i ndihmës ligjore falas, takimet informuese dhe sensibilizuese të realizuara në komunitet, shkolla dhe me përfaqësues të institucioneve në lidhje me adresimin e çështjeve të barazisë gjinore dhe funksionimin e mekanizmit të referimit dhe nënshkrimin e marrëveshjeve përkatëse, takime me studentë dhe nxënës të shkollave 9 vjeçare dhe të mesme. Ndërthurja mes takimeve ndërgjegjëse, përdorimit të kanaleve mediatike dhe ofrimit konkret të shërbimeve konsiderohet si instrumenti më i fuqishëm për t’u ofruar vajzave dhe grave një rrugëdalje nga situatat e dhunës.

Instrumentat inovativ që përdorin të rinjtë konsiderohen si shumë efektive dhe mund të përdoren gjatë. Si instrument të suksesshëm janë përmendur *videot e shkurtra që adresojnë stereotipet gjinore, fletëpalosjet me informacione kyçe, banderolat, posterat, dhe përdorimi i artit si instrument*. Për shembull, një ekspozitë e hapur në Lezhë e realizuar nga Strehëza për Gratë dhe Vajzat pati ndikim të madh. Edhe teatri shëtitës dhe emisionet televizive janë përmendur si instrumente të suksesshëm.

2.8 Kanalet më efektive të informacionit

Janë disa kanale të përdorura dhe ka një dakordësi të të intervistuarve se këto kanale kanë plotësuar njëri-tjetrin. Pra, fushatat kanë pasur shumë mjete komunikimi për dhënien e informacionit dhe nuk mund të thuhet se njëri nga kanalet e informacionit të përdorur ka qenë më i mirë se të tjerët. Kombinimi i kanaleve do të ishte ideale për ta përçuar mesazhin në target grupe të ndryshme, të zonave ndryshme dhe profileve të ndryshme. Nëse target grupi është i qartë, për shembull të rinjtë, mediat dhe rrjetet sociale kanë një ndikim më të madh në ditët e sotme. Por, çdo target grup ka kanalet e veta që preferon, që mund të përdoren për informim dhe ndërgjegjësim dhe duhen gjetur mënyrat e duhura dhe të alternohen ato për përcjelljen e informacionit. Për shembull, pavarësisht moshës, gratë rome shpesh kanë nivel të ulët arsimor, apo nuk preferojnë të vijnë në qendra apo aktivitete që janë larg zonës së tyre të banimit, ndaj me to realizohen takime informale ose derë më derë si forma më e përshtatshme e përcjelljes së informacionit. *Praktika “derë më derë”* ka ndihmuar shpesh të arrihen grupet më të cënueshme, si ato rome/egjyptiane. Kjo praktikë e fundit është përdorur në mënyrë efektive edhe për personat me aftësi të kufizuar që nuk kanë akses në internet apo fizikisht nuk mund të lëvizin.

- *Puna në komunitet dhe puna sidomos me të rinjtë*, bisedat në shkolla, videot, arti, shpërndarja e informacionit nëpërmjet prodhimit dhe shpërndarjes së fletëpalosjeve me informacion konkret se ku mund të kërkohet ndihmë, konsultimet dhe takimet ballë për ballë janë të nevojshme për të

² Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 150, datë 18 janar 2007.
Ligji nr.9914, datë 12.5.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 76, datë 28 maj 2008.
Ligji nr.10 329, datë 30.9.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 142, datë 25 tetor 2010.
Ligji nr. 47/2018, datë 23.7.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 115, datë 3 gusht 2018.

përcjellë informacionin e duhur tek kategoritë përkatëse. Fushatat ndërgjegjësuere bëhen më efektive në bashkëpunimin me OJQ-të dhe të gjithë grupet e interesit.

- *Media sociale* ka qenë shumë e rëndësishme dhe efikase pasi mund të arrihen grupe të mëdha njerëzish për shkak të masivitetit dhe lehtësisë në përdorim.
- *Radio dhe Televizioni (sidomos kanalet kombëtare)*, dhe prezenca audio-vizive në emisione e programe përbëjnë një mjet shumë të fuqishëm në përçimin e mesazheve të duhura dhe me profesionalizëm, për informim, ndërgjegjësim dhe ngritjes së çështjeve për zgjidhje. Media lokale përdoret shpesh për të arritur tek ata njerëz në komunitet të cilët nuk kanë akses në median sociale. Radio spotet konsiderohen një kanal shumë i mirë informacioni për të rritur raportimin.
- Tjetër mjet efektiv konsiderohen edhe *forumet e diskutimit me grupe të fokusuara*, ku pjesëmarrësve iu është dhënë informacion praktik mbi mbrojtjen që iu ofron legjislacioni në fuqi dhe hapat që duhet të ndjekin. Gjatë bashkëbisedimit pjesëmarrësit e kanë më të lehtë të kuptojnë se si mund t'i adresojnë problemet që kanë dhe të ndërgjegjësohen mbi mos tolerimin e sjelljeve që çenojnë mirëqenien e tyre.

2.9 Ndërhyrjet në të ardhmen në fushën e BGJ, DhNGV, DHF

Ndërhyrjet që konsiderohen të nevojshme për t'u realizuar në të ardhmen, janë:

➤ KUADRI LIGJOR, POLITIK:

- *Përmirësimi i politikave me qasje gjinore, dhunës në familje dhe dhunës kundër grave në familje*; Forcimin e politikave, plan-veprimeve dhe strategjive për promovimin e barazisë gjinore, duke përfshirë legjislacionin që mbron gratë dhe vajzat nga të gjitha format e DhNG-së, duke përfshirë forma të reja apo të pranuar rishtazi të DhNG-së, si ngacmimi seksual dhe përndjekja përmes teknologjisë, dhe format e DhNG-së që janë të nën-raportuara nga gratë në polici dhe në agjencitë e drejtësisë dhe në organizatat për mbrojtjen e viktimave. Të bëhet një legjislacion në përputhje me konventat e ratifikuara dhe këtu kemi parasysh hartimin e një ligji kuadër kundër dhunës ndaj grave dhe për këtë AP ka qenë inicues i realizimit të një tryeze me përfaqësues të shoqërisë civile në qershor të këtij viti ku u diskutua nëse në Shqipëri është e nevojshme hartimi i një ligji të tillë siç e përcakton dhe konventa e Stambollit.
- Në kuadrin ligjor, kuadrin politikbërës, mekanizmat e referimit dhe ndërgjegjësimi sidomos me fokus grupe të caktuara siç janë gratë/vajzat romë dhe egjiptiane, LGBTI etj.
- Emergjencë është *rregullimi i legjislacionit për prokurimet sociale dhe ligji për OJF-të*.
- Qeveria Qendrore dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore duhet të sigurojnë ekzistencën e mekanizmave të financimit për të mbështetur parandalimin e DhNG-së dhe programe e iniciativa për ndërhyrje, të cilat kontribuojnë në mbrojtjen e grave dhe vajzave nga të gjitha format e dhunës. Financimi është i nevojshëm për ofrimin e shërbimeve esenciale cilësore për të mbijetuarat e DhNG-së dhe për rritjen e ndërgjegjësimin në lidhje me gamën e shërbimeve të besueshme të disponueshme për viktimat dhe të drejtat e grave dhe vajzave për mbrojtje nga dhuna.
- Krijimi i një kurrikule për vajzat dhe djemtë në shkollat fillore dhe të mesme në bashkëpunim me OJF-të për të parandaluar pabarazinë gjinore dhe dhunën ndaj grave në moshë të re.
- Përmirësimi i politikave sociale, të këtyre grupeve vulnerabël lidhur me strehimin dhe asistencën financiare. Rritja e aksesit të këtyre grupeve vulnerabël, në sistemin e drejtësisë, në tregun e punës; Gratë e komunitetit rom duhet të kenë mundësinë që në institucione të shprehen në gjuhën që kuptojnë më mirë. Dokumentacioni i nevojshëm duhet të përshtatet në këtë gjuhë.
- Për BGJ ka shumë punë për të bërë duke filluar me *forcimin e mekanizmit të BGJ* dhe duke vazhduar me kontributin e qenësishëm të grave dhe vajzave në procesin vendimmarrës, pra nuk janë vetëm shifra. Fakti që ka gra në Këshillat Bashkiak,

kabinetet ministore dhe në parlament jo domosdoshmërit do të thotë se kemi një axhendë të arritur të BGJ por duhet të kemi një kontribut dhe dëgjim të zërit të tyre.

➤ **PROGRAME REHABILITIMI DHE OFRIMI I SHËRBIMEVE PËR TË DHUNUARIT**

- Është e nevojshme të ngrihen programe të rehabilitimit për dhunuesit në mënyrë të veçantë ata që kanë probleme të shëndetit mendor, përdoruesit e drogave dhe alkoolit.
- Një tjetër ndërhyrje është edhe *ndihma juridike falas*. Disa organizata ofrojnë ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës në familje, por në mënyrë të qendrueshme duhet të ofrohet nga shteti.
- *Destigmatizimi i raportimit të dhunës seksuale dhe ofrimi i shërbimeve të duhura shëndetësore dhe psikologjike për të mbijetuarat e dhunës seksuale*. Është e domosdoshme ndërhyrja e strukturave përgjegjëse për shtimin e programeve mbështetëse në dispozicion për këtë kategori dhe në mbështetje të Strehëzave Emergjente dhe për viktimat e dhunës seksuale.
- Duhet të merren masa për *krijimin e mundësive reale për punësim e strehim* për gratë/vajzat e prekura nga dhuna në familje apo dhuna me bazë gjinore. Në zbatim të detyrimeve të parashikuara në Ligjin “Për strehimin Social”, Bashkitë duhet të angazhohen për ngritjen e banesave të specializuara për viktimat/të mbijetuarat nga dhuna në familje. Institucionet të bashkëpunojnë me shoqërinë civile përsa i përket çështjes së dhunës dhe ta shikojnë si një partner për ta mbështetur edhe financiarisht. Bashkëpunimi i institucioneve me organizatat e shoqërisë civile që janë të specializuara në dhënien e këtyre shërbimeve.
- Është e nevojshme që *bashkitë të kenë një fond të posaçëm për mbështetjen e viktimave të mbijetuara nga dhuna që janë në vështirësi ekonomike*. Të ndajnë buxhete në lidhje me të drejtat e grave, barazinë gjinore dhe DHF. Të shpërndahet buxheti i duhur që të mos mbeten këto target grupe në mëshirë të fatit dhe donatorëve. Buxhetet janë gjithmonë të pamjaftueshme në çështjet e dhunës ndaj grave në përgjithësi dhe atyre me aftësi të kufizuar në veçanti.
- Është e rëndësishme që të rritet fokusi në ndryshimin e sjelljeve të gabuara, *pra drejt shërbimeve parandaluese*, sesa vetëm në ndërgjegjësim. Shërbimet parandaluese janë të rëndësishme pasi kanë më pak kosto se shërbime rehabilituese. Shërbimet parandaluese janë ato që në shportën e shërbimeve sociale sot njihen si shërbime parashoqërore, që mund të ofrohen atje ku është individi dhe të tilla janë shërbimet e këshillimit, shërbimet për familjen, pra qendrat komunitare që identifikojnë rastet që në fazat e para.
- *Fuqizimi ekonomik i grave*. Duke patur sa më shumë gra dhe vajza të arsimuara dhe të punësuar aq më të pakta do të jenë dhe rastet e dhunës. Fuqizimi ekonomik i grave sidomos në zonat rurale dhe realizimi i të drejtave të tyre (të pronësisë, për punë, shëndetësore dhe për arsim) të para në kuadër të të drejtave të njeriut.
- Mbështetja e OJF-ve në përpjekjet e tyre për të promovuar diskutime midis brezave për të mundësuar ndarjen e perspektivave dhe për të sfiduar kulturën e heshtjes që rrethon dhunën ndaj grave. Kjo mund të përfshijë angazhimin e grave më të shprehura, veçanërisht në zonat rurale dhe të largëta për të arritur gratë e tjera që ende e konsiderojnë dhunën një aspekt normal të një martese / marrëdhënieje.
- Funksionimi i mekanizmit të BGJ në të gjithë vendin deri tek bashkitë më të largëta. *Mbështetja me shërbime riintegruese* të cilat nuk janë të shtrira në të gjithë territorin. Një ndërhyrje e rëndësishme është shtrirja e shërbimeve në mbështetje të viktimave të dhunës.

➤ **RRITJA E KAPACITETEVE PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE**

- Institucionet publike dhe jo publike duhet të kujdesen për *rritjen e kapaciteteve të punonjësve* të tyre dhe mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile në punën e tyre.
- *Ngritja e kapaciteteve të institucioneve dhe organizatave*, sepse shpesh njohuritë janë të përgjithshme, për shembull ka njohuri të shumta për dhunën, por jo për gratë me aftësi të

kufizuara. Për çështje të aftësisë së kufizuar dhe dhunës janë të nevojshme edhe ndërhyrjet ligjore sepse legjislacioni është i pa plotësuar dhe diskriminues e ka nevojë për përmirësim. Legjislacioni nuk përfshin shpesh çështjet e grave me AK, grave rome/egjyptiane ose LGBTI.

- Me ligjin e vitit 2018 tashmë gjykatat janë ato që e kanë në dorë referimin e burrave dhunues në programe rehabilitimi. Për këtë *duhet rritur informacioni dhe trajnimi për gjyqtarët* nëpërmjet trajnimeve dhe ndërgjegjësimit në gjykatën e Tiranës dhe Durrësit për referimin e rasteve të burrave dhunues që të mund t'u ofrohen programet rehabilituese.
- *Koordinimi i palëve të interesit*, ndërtimi i kapaciteteve, shkëmbimi i praktikave më të mira, kanalizimi i akteve nënligjore dhe praktikave dhe mangësive të vazhdueshme, shoqëruar me mentorimin, këshilla të ekspertëve të kërkesës nga partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë të zhvillimit.
- Bashkëpunimi me të gjithë palët e interesuara për të mbledhur të gjitha të dhënat përkatëse kombëtare për çështjet gjyqësore mbi DhBGj në një bazë të dhënash qendrore dhe të kryejnë studime sistematike mbi të dhënat.
- Trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve për çështjet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe ofrimi i trajnimeve për legjislacionin përkatës të ri.
- Trajnimi i profesionistëve të kujdesit shëndetësor për të luajtur një rol më aktiv në mekanizmat e referimit, në inkurajimin e grave për të raportuar rastet e dhunës në përgjithësi dhe në mbështetjen e të mbijetuarve.
- Mbështetja e trajnimeve mbi etikën në lidhje me gjininë për median për të trajtuar më mirë paragjykimet ekzistuese gjinore që arrijnë një audiencë të gjerë. Gjithashtu, trajnimi i gazetarëve të rinj për raportim të drejtë të dhunës me bazë gjinore për të mos fajësuar të mbijetuarin për dhunën që ajo përjetoi. Policia duhet të trajnohet për nevojat specifike e kulturore të një komuniteti të caktuar në drejtim të pritjes së tyre në institucione.

➤ **ORGANIZIMI I FUSHATAVE TË NDRYSHME**

- *Ndërgjegjësimi i grupeve vulnerabël*, lidhur me aksesin në drejtësi, dhe aksesin në pasuritë e paluajtshme, lidhur me aksesin në tregun e punës, lidhur me aksesin social si; strehim dhe asistencë sociale; marrja e masave parandaluese dhe mbrojtjen e grupeve vulnerabël, me qëllim që në të ardhmen të mos jenë subjekte të dhunës.
- *Puna me të rinjtë dhe sidomos me ata që jetojnë në zona rurale ose në periferi të qyteteve*. Vitin e kaluar është bërë një studim për dhunën e adoleshentëve në marrëdhënie intime ndërmjet tyre në këtë drejtim dhe ka ende punë për të bërë.
- Zbatimi i fushatave sensibilizuese mbi dhunën seksuale, veçanërisht në marrëdhëniet intime, në bashkëpunim me OJF-të e grave.
- Kryerja e seancave informuese, veçanërisht me gratë rurale, në lidhje me burimet, institucionet dhe proceset që merren me raste të dhunës ndaj grave.
- *Përfshirja në çështjet e dhunës të grave me AK* ose të pafavorizuara gjatë realizimit të fushatave që adresojnë luftën kundër stereotipeve gjinore.
- *Emisione enkas në media* për çështjen e diversitetit gjinor, barazisë gjinore, dhunës ndaj grave dhe mbrojtjes së fëmijëve. Realizimi i videove dhe dokumentarëve mbi eksperiencat më të mira të vendeve të BE për të parë një qasje ndryshe, modele e stereotipe edhe të vendeve fqinje në mënyrë që edhe ne të përçojmë tek njerzit historitë njerëzore të grave të dhunuara, femrave që kanë thyer tabu për çështjet e diversitetit gjinor.
- *Lobimi dhe rritja e presionit të shoqërisë civile* për çështjet që nuk u janë dhënë zgjidhje nga shteti përmes marshimeve, protestave në rrugë për të drejtat e grave, gratë e abuzuara, gratë e dhunuara, të trafikuar si dhe gratë që nuk kanë gjetur zgjidhje nga institucionet.
- Përdorimi sa më shumë i kanaleve të *medias sociale dhe medias online* për të rritur ndërgjegjësimin, informacionin dhe aksesin në shërbime. Vizibiliteti, publikimi në Media

- i fushatave, përdorimin e teknologjise dhe mjeteve moderne të komunikimit për shpërndarjen masive të mesazheve.
- *Organizimi i fushatave gjithpërfshirëse*, transparente, jo sporadike dhe të mbivendosura. Financimi i shoqërisë civile në mënyrë që të organizojnë fushata ndërgjegjësuese për BGJ dhe DHF.
 - *Përfshirjen e burrave dhe djemve* në fushata informimi e ndërgjegjësimi.
 - *Nëpërmjet fushatave të promovohen modele pozitive*, pra të grave që ja kanë dalë dhe profesionistëve të mirë (ofruer të mirë shërbimesh duke ndikuar në rritjen e besimit) pasi ka ndikim të madh tek gratë e tjera duke bërë të mundur dhe rritjen e raportimit të rasteve të dhunës.
 - *Dhënia e mesazheve të qarta*.
 - *Përdorimi sa më shumë i teknologjisë*.
 - *Matja në mënyrë profesionale e impaktit të fushatave* të tilla ndërgjegjësuese që edhe shoqëria civile që i organizon ato të jetë në dijeni të masës së ndikimit të tyre në publik.
 - *Edukimi ligjor i publikut për çështjet e BGJ dhe DHF* i cili duhet të përdoret masivisht nga organizatat e shoqërisë civile.

III. SHTOJCA A: LISTA E PERSONAVE TË INTERVISTUAR

Nr.	I/ E intervistuar	Organizata/ Institucioni	Data	Ballë për ballë/ Online
1.	Tetis Lubonja	Ministria e Drejtësisë	17.10.2019	Online
2.	Ejnxh Pepa	Linja e këshillimit për gratë dhe vajzat	21.10.2019	Ballë për ballë
3.	Sidita Fortuzi	Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (ADRIF)	22.10.2019	Ballë për ballë
4.	Alma Katragjini	Policia Vendore Tiranë	23.10.2019	Ballë për ballë
5.	Aferdita Prroni	Qendra Të Drejtat e Njeriut në Demokraci (QDNJD)	25.10.2019	Ballë për ballë
6.	Gertjana Hasalla	Forumi i Gruas Elbasan	25.10.2019	Online
7.	Edlira Papavangjeli	UNDP	28.10.2019	Ballë për ballë
8.	Irena Straza	Rrjeti AWEN	30.10.2019	Ballë për ballë
9.	Elton Lelo	Prezenca e OSCE-së në Shqipëri	31.10.2019	Online
10.	Mirela Arqimandriti	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë	05.11.2019	Ballë për ballë
11.	Aurela Bozo	Qendra per Nisma Ligjore Qytetare	11.11.2019	Online
12.	Marsela Allmuça	Strehëza për grate dhe vajzat	15.11.2019	Ballë për ballë
13.	Manjola Veizi	Qendra për të drejtat e grave rome	18.11.2019	Ballë për ballë
14.	Etleva Sheshi	Avokati i Popullit	19.11.2019	Ballë për ballë
15.	Brunilda Dervishaj	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	22.11.2019	Ballë për ballë
16.	Ardiana Hala	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)	27.11.2019	Online
17.	Migena Kokeri	Bashkia Tiranë	02.12.2019	Online
18.	Marsida Sejdini	Bashkia Elbasan	01.12.2019	Online
19.	Brunilda Minarolli	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	03.12.2019	Online